



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu
Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/279

Datë: 3 / 6 / 2025

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 14, paragrafi 2, nënparagrafët 2.6 dhe 2.13, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, pas propozimit të rektorit, në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2025, miratoi:

RREGULLORE

PËR TË ARDHURAT DHE KOMPENSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat e kompensimit të personelit akademik të rregullt dhe të angazhuar në Universitetin e Prishtinës, përfshirë edhe shtesat për ushtrimin e funksioneve, komisionet dhe punën shtesë, apo aspektet e tjera që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ndikojnë në të ardhurat dhe kompensimin e personelit akademik, bazuar në legjislacionin në fuqi, përfshirë këtë rregullore dhe aktet e tjera në fuqi në UP.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë për të gjithë të punësuarit në Universitetin e Prishtinës, në cilësinë e personelit akademik, qofshin ata me marrëdhënie të rregullt pune apo në bazë të një marrëveshjeje kontraktuale për angazhim me UP-në.

Neni 3

Përkufizimet dhe shkurtesat

Për qëllime të kësaj rregulloreje, shprehjet dhe shkurtesat e mëposhtme kanë kuptimin si në vijim:

- **MASHTI** - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- **UP** - Universiteti i Prishtinës.
- **Bashkëpunëtor i jashtëm** – Mësimdhënësi/ja, lektori/ja ose asistenti/ja i/e angazhuar në marrëdhënie jo të rregullt pune me UP-në ose me marrëdhënie të rregullt pune të pezulluar, sipas ligjeve dhe vendimeve përkatëse, me një fond të caktuar orësh dhe në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara sipas rregulloreve në fuqi të UP-së. Kjo përfshin edhe personelin e angazhuar përmes bashkëpunimeve me ambasada, agjenci shtetërore dhe organizata ndërkombëtare si dhe ekspertë që mbajnë orë praktike (klinike) sipas programeve të akredituara, në bazë të marrëveshjeve që ka UP-ja ose njësitë akademike, respektivisht bazuar në rregulloren në fuqi për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP.
- **Normë e plotë** - Nënkupton fondin e orëve mësimore për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP, e cila pasqyrohet edhe në kontratën e punës.
- **Punë shtesë** - Punë ose angazhim me orë shtesë, që tejkalojnë orët e përcaktuara për normë të plotë, në rastin e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP.
- **Koeficienti** - Nënkupton shprehjen numerike që korrespondon me klasën dhe grupin e pagës. Bazuar në këtë koeficient, llogaritet paga bazë për çdo pozicion.
- **Legjislacion në fuqi** - Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, nënkupton: Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë; Ligjin në fuqi për Pagat në Sektorin Publik; Ligjin në fuqi për Arsimin e Lartë; Statutin e UP-së dhe aktet e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.
- **Pagë shtesë** - Pagë shtesë në përqindje të pagës bazë, e cila i takon personelit akademik për punën më të gjatë se orët e përcaktuara me normë të plotë dhe për punë gjatë fundjavës.
- **Shtesë funksionale** - Shtesa funksionale, e cila i takon personelit akademik për ushtrimin e funksionit përkatës, siç parashihet në legjislacionin e zbatueshëm dhe në Statutin e UP-së.
- **Funksionarë publikë** - Nënkupton: të zgjedhurit; anëtarët e qeverisë dhe zëvendësit e tyre; funksionarët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura; të emëruarit politik në nivelin qendror dhe lokal; drejtori apo anëtarët e organit drejtues kolegjial të agjencive rregullatore.
- **Profesor vizitor/i ftuar** - Nënkupton mësimdhënësin e angazhuar nga një universitet dhe institucion tjetër ndërkombëtar i arsimit të lartë.
- **SEMS** - Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Studentëve.

Neni 4

Planifikimi i shpenzimeve për kompensimin e personelit akademik

1. Universiteti i Prishtinës, në koordinim me njësitë akademike dhe trupat e tjerë brenda UP-së, bën planifikimin e buxhetit vjetor për të mbuluar koston e kompensimit të personelit në marrëdhënie të rregullt pune dhe të angazhuar. Mjetet për kompensimin e personelit akademik të rregullt dhe të angazhuar planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor të miratuar të UP-së.
2. Shuma e të ardhurave dhe kompensimeve të tjera caktohet në bazë të koeficientëve dhe thirrjeve, sipas kodimit unik për të gjithë nëpunësit publikë të arsimit në Kosovë.
3. Njësia përkatëse për financa në UP përlogarit të ardhurat dhe kompensimet e tjera bazuar në vendimet dhe kontratat e nënshkruara me personelin akademik të UP-së. Mbi këtë bazë, menaxhmenti i UP-së jep urdhër për realizimin e pagesave sipas vendimeve dhe kontratave që lidhen me personelin akademik të punësuar dhe të angazhuar.
4. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, gjatë çdo viti buxhetor, UP-ja, në bashkëpunim me njësitë akademike dhe mekanizmat e tjerë të përcaktuar sipas rregulloreve në fuqi, bën planifikimin buxhetor për punësimin e personelit akademik të ri, avancimin dhe riemërimin e personelit ekzistues, si dhe angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Neni 5

Kufizimet në marrëdhënien e punës me normë të plotë dhe kompensimi

1. Personeli i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune në UP nuk mund të ketë një kontratë tjetër pune me normë të plotë në një universitet apo institucion tjetër. Personeli akademik mund të jetë i angazhuar në institucione tjera në cilësi të ekspertit, konsulentit apo në trupa të tjerë në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit Drejtues të UP-së.
2. Kriteret për kufizimet mbi angazhimet shtesë të personelit akademik në një institucion tjetër, qoftë brenda apo jashtë vendit, përcaktohen nga legjislacioni i zbatueshëm dhe vendimet relevante të Këshillit Drejtues të UP-së.
3. Personeli akademik që mban pozitën e deputetit në Kuvendin e Kosovës, bazuar në ligjet e zbatueshme, kompensohet vetëm nëse mban orë mësimore, deri në 20% të pagës, në përputhje me thirrjen akademike që mban.
4. Personeli akademik që mban një pozitë publike tjetër në Republikën e Kosovës, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, kompensohet vetëm për orët e mbajtura, bazuar në këtë rregullore.

II. KOMPENSIMI I PERSONELIT AKADEMIK NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE

Neni 6

Kompensimi i personelit akademik në kuadër të marrëdhënies së punës

1. Personeli akademik me marrëdhënie të rregullt pune në UP punësohet me kontratë pune me kohë të caktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet për emërim sipas titullit akademik të përcaktuar në Statutin e UP-së.
2. Në rastet kur kontrata e punës për personelin akademik skadon për shkak të vonesave objektive jashtë vullnetit të tij/saj në procesin e riemërimit ose avancimit (si pasojë e shtyrjes së procedurave të konkursit apo të emërimit/riemërimit), kontrata ekzistuese vazhdohet automatikisht në të njëjtin titull akademik deri në përfundimin e procedurave përkatëse të avancimit/rizgjedhjes.
3. Për personelin e rregullt akademik me kontratë pune me normë të plotë (40 orë në javë), në detyrimet e punës përfshihen:
 - 3.1 Përgatitja dhe zhvillimi i ligjëratave dhe ushtrimeve në njësinë/njësitë akademike ku personeli është i punësuar, në përputhje me normën e përcaktuar në tabelën 1 të kësaj rregulloreje;
 - 3.2 Mbikëqyrja (mentorimi) e punimeve të diplomës në nivelin bachelor dhe master. Për nivelin master deri në normën e përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje;
 - 3.3 Pjesëmarrja në komisione akademike, brenda njësisë akademike, duke përfshirë komisionet e punimeve të nivelit bachelor dhe master;
 - 3.4 Organizimi dhe mbajtja e provimeve dhe konsultimeve me studentë;
 - 3.5 Angazhimi në procesin e akreditimit të programeve të studimit të njësisë akademike;
 - 3.6 Angazhimi në zbatimin e procedurave të konkurseve për pranimin e studentëve në programet bachelor, master dhe doktoratë;
 - 3.7 Pjesëmarrja në takimet e organeve kolegjiale: Këshilli i njësisë akademike; komisionet e themeluara nga njësia akademike, departamentet e njësisë akademike;
 - 3.8 Kryerja e detyrave dhe angazhimeve të tjera akademike në kuadër të njësisë akademike, në të cilën është zgjedhur, siç përcaktohet në aktet normative të UP-së dhe kontratën e punës.
4. Kompensimi i personelit akademik për angazhimet sipas normës së plotë, si dhe për detyrat dhe përgjegjësitë shtesë, bëhet në përputhje me vendimet e organeve kompetente të UP-së, të nxjerra sipas kësaj rregulloreje si dhe kontratave individuale të lidhura ndërmjet UP-së dhe personelit akademik.

Neni 7

Kompensimi për normën e rregullt të personelit akademik

1. Kompensimi i personelit të rregullt akademik për punën me orar të plotë konsiderohet me një kohëzgjatje prej dyzet (40) orësh në javë.
2. Për personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune, caktohet norma e plotë e orëve javore të mësimdhënies, niveli i pagës sipas titullit akademik, si dhe detyrat përkatëse të përfshira në normën e rregullt.
3. Për orët shtesë që tejkalojnë normën e plotë javore, personeli akademik ka të drejtë për kompensim shtesë, të llogaritur në përqindje të pagës bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas kësaj rregulloreje.
4. Norma e plotë e orëve javore të mësimdhënies dhe pagesa përkatëse përcaktohen si më poshtë.

Tabela nr. 1¹

Nr.	Titulli akademik	Norma e plotë e orëve javore të mësimt	Koeficienti		Paga bazë (€)	
			Janar 2025	Korrik 2025	Janar 2025	Korrik 2025
1	Profesor/e i/e rregullt	6 (gjashtë)	12.9	13.4	1,419	1,474
2	Profesor/e i/e asociuar	6 (gjashtë)	11.9	12.4	1,309	1,364
3	Profesor/e asistent/e	6 (gjashtë)	10.9	11.4	1,199	1,254
4	Ligjërues/e	6 (gjashtë)	9.1	9.6	1,001	1,056
5	Lektor/e	10 (dhjetë)	8.0	8.5	880	935
6	Korepetitor/e	10 (dhjetë)	8.0	8.5	880	935
7	Asistent/e	10 (dhjetë)	7.7	8.2	847	902

5. Në rast se personelit akademik, me thirrjen profesor, i rrezikohet norma e rregullt e ligjëratave, me qëllim të kompensimit, të njëjtit mund të mbajnë deri në dy (2) orë ushtrime brenda semestrit, për të plotësuar orët mësimore të përcaktuara për normë të rregullt, sipas kontratës.
6. Për qëllim të kompensimit dhe implikimeve buxhetore, kusht për shpalljen e konkursit për vendet e reja në UP, për mësimdhënës, asistentë, lektorë dhe korepetitorë është plotësimi i së paku 50% të orëve të parapara me normë të plotë në lëndët obligative, kurse pjesa tjetër në lëndët zgjedhore ose në praktikën klinike në Fakultetin e Mjekësisë. Norma e plotë llogaritet për një vit akademik.
7. Asistentët e autorizuar për ligjërata në nivelin bachelor, në përputhje me Statutin e UP-së, kompensohen për orët e mbajtura si ushtrime, bazuar në pagën bazë.

¹ Bazuar në vendimin e qeverisë/kuvendit, koeficienti për vitin 2025 do të ndryshojë me efekt nga data 1 korrik 2025. Vlera e koeficientit apo koeficienti do të ndryshojë me automatizëm sipas vendimeve të qeverisë/kuvendit.

8. Llogaritja dhe kompensimi për përvojën e punës realizohet në përputhje me legjislacionin aktual në Republikën e Kosovës, mbi pagën bazë të përcaktuar në tabelën e përmendur në paragrafin 4 të këtij neni.

Neni 8

Kompensimi i personelit akademik për orët dhe angazhimet shtesë

1. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP ka të drejtë për kompensim shtesë për çdo orë mësimore të mbajtur jashtë normës së plotë, sipas nenit 7, paragrafi 4, tabela nr. 1, dhe në bazë të shtojcës 1 dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP i takon kompensim shtesë për çdo angazhim shtesë që nuk është përfshirë në detyrat e punës, të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje dhe bazuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje dhe akteve tjera në fuqi të Universitetit të Prishtinës.
3. E drejta për kompensim shtesë zbatohet deri në kufirin prej 30% të pagës bazë dhe në proporcion me numrin e orëve të punës shtesë. Llogaritja e kompensimit për orët shtesë dhe detyrat e tjera, siç parashihet në paragrafin 2 të këtij neni, bazohet në pagën bazë sipas thirrjes akademike.
4. Përveç orëve mësimore, punë shtesë do të konsiderohen edhe orët e angazhimit që tejkalojnë normën e përcaktuar për detyrat dhe përgjegjësitë tjera siç specifikohet më poshtë:
 - 4.1 Mentorimi i temave të masterit brenda një viti akademik, sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje;
 - 4.2 Pjesëmarrja në komisione, trupa profesionale dhe kryerja e detyrave shtesë të përcaktuara nga organet e Universitetit të Prishtinës, përfshirë këshillin drejtues, rektorin/en dhe senatin, bazuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
5. Për angazhimin e personelit akademik të rregullt në detyra jashtë njësisë akademike, përfshirë pjesëmarrjen në komisione apo trupa në nivel të Universitetit të Prishtinës, sipas shtojcës 1, të cilat nuk bëjnë pjesë në përshkrimin e detyrave të punës, të përcaktuara në këtë rregullore, universiteti mund të kompensojë personelin për këto detyra shtesë, nëse ato janë aprovuar paraprakisht nga këshilli drejtues, senati apo rektori/ja, përmes një vendimi përkatës. Kompensimi për detyrat shtesë bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionin aktual që rregullon pagat e shërbyesve publikë.
6. Orët shtesë të punës nuk mund të transferohen nga një semestër në tjetrin. Për të caktuar dhe kompensuar orët shtesë në një vit akademik, është kusht i domosdoshëm që norma e plotë për vitin akademik të jetë përmbushur paraprakisht. Pasi të jetë përmbushur norma e plotë për personelin akademik në kuadër të programit apo departamentit (për mësimdhënësit me ligjërata dhe asistentët me ushtrime), orët e tjera mund të kompensohen si punë shtesë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Pavarësisht llogaritjes së normës së plotë për një vit akademik, kompensimi për orët mësimore shtesë bëhet vetëm në semestrin përkatës të vitit akademik, ku këto orë janë mbajtur.

III. KOMPENSIMI PËR PERSONELIN E ANGAZHUAR

Neni 9

Angazhimi dhe kompensimi i personelit akademik me kontratë jo të rregullt

1. Universiteti i Prishtinës, në përputhje me rregulloret e brendshme dhe bazuar në nevojat akademike, ka të drejtë të angazhojë dhe kompensojë personelin akademik për periudha të caktuara sipas përcaktimeve përkatëse:
 - 1.1 Bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime;
 - 1.2 Profesorë vizitorë;
 - 1.3 Ekspertë të praktikës për mbajtjen e orëve klinike në programet studimore të akredituara, sipas marrëveshjes që ka universiteti ose njësitë akademike;
 - 1.4 Profesorë Emeritus;
 - 1.5 Anëtarë të jashtëm të komisionit të doktoratës;
 - 1.6 Personeli akademik i pensionuar që ka pasur marrëdhënie të rregullt në UP (sipas vendimit në fuqi të qeverisë), por jo përtej moshës 70-vjeçare.
2. Personeli akademik i pensionuar, që më parë ka pasur marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prishtinës, mund të angazhohet për mësimdhënie deri në katër (4) orë në javë, në varësi të titullit akademik. Kompensimi për këto orë mësimore bëhet në bazë të përqindjes (%) së përcaktuar për kompensimin shtesë të personelit me marrëdhënie të rregullt pune, siç specifikohet në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje. Angazhimi i këtij personeli bëhet bazuar në nevojat e njësive akademike dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, deri në plotësimin e pozitës me personel të rregullt.
3. Profesorët me titullin Emeritus mund të kompensohen deri në moshën 70-vjeçare, në pajtim me Statutin e Universitetit të Prishtinës.

Neni 10

Kompensimi për bashkëpunëtorët e jashtëm në UP

1. Bashkëpunëtorëve të jashtëm u takon kompensimi për çdo orë të mbajtur, në përputhje me përcaktimet e shtojcës nr. 1 të kësaj rregulloreje.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm kanë të drejtë për kompensim për një periudhë që nuk tejkalon tetë (8) muaj brenda vitit akademik, bazuar në orët e realizuara, siç përcaktohet në këtë rregullore.

3. Ekspertëve të praktikës, të cilët mbajnë orë klinike sipas programeve të akredituara, gjithashtu u takon kompensim në këtë kategori, bazuar në marrëveshjet e arritura nga UP-ja ose njësitë akademike me institucionet publike përkatëse. Lartësia e kompensimit për këtë kategori përcaktohet në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Kompensimi i profesorëve vizitorë

1. Profesorët vizitorë kompensohen në përputhje me shtojcën 1 të kësaj rregulloreje:
 - 1.1 Kompensimi i profesorëve vizitorë realizohet pas angazhimit të tyre, sipas rregullave në fuqi të UP-së dhe rregullores përkatëse për bashkëpunëtorë të jashtëm;
 - 1.2 Profesorëve vizitorë nuk mund t'u kompensohen më shumë se njëzetekatër (24) orë gjatë një muaji, të cilat mund të mbahen sipas sistemit bllok, por jo më shumë se gjashtë (6) orë brenda një dite të punës;
 - 1.3 Profesorëve vizitorë nga vendet jashtë rajonit do t'u mbulohen shpenzimet e biletës së udhëtimit, por vetëm një (1) biletë kthyesë, sipas çmimit të arsyeshëm (ekonomik). Bileta sigurohet dhe paguhet nga Universiteti i Prishtinës, sipas procedurave përkatëse;
 - 1.4 Buxheti për profesorët vizitorë miratohet nga këshilli drejtues, pas propozimit të rektorit/es, dhe rishikohet në intervale të caktuara vjetore (së paku dy herë në vit);
 - 1.5 Me kërkesë të arsyetuar nga rektori/ja, skema e përfituesve nga radhët e profesorëve vizitorë mund të zgjerohet me vendim të këshillit drejtues, por vetëm brenda lartësisë së buxhetit të aprovuar për vitin përkatës.

Neni 12

Fondi i orëve për bashkëpunëtorë të jashtëm dhe profesorë vizitorë

Kompensimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, si dhe i profesorëve vizitorë, realizohet bazuar në fondin e orëve, të përcaktuar në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Kompensimi i ekspertëve të praktikës për mbajtjen e orëve klinike në programet studimore të akredituara, sipas marrëveshjes që ka universiteti ose njësitë akademike

1. Kompensimi i ekspertëve të praktikës, të angazhuar për mbajtjen e orëve klinike në programet studimore të akredituara, realizohet në përputhje me marrëveshjet e arritura

nga universiteti ose njësitë akademike dhe sipas shumës së përcaktuar në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

2. Fondi i orëve për ekspertët e praktikës përcaktohet në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Kompensimi në studimet e doktoratës

1. Orët e mbajtura në studimet e doktoratës llogariten si orë shtesë sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, ose si pjesë e normës së rregullt, në rastet kur personeli akademik nuk ka orë të mjaftueshme të mbajtura në nivelet e tjera të studimeve.
2. Kompensimi i mentorit dhe anëtarëve të jashtëm të komisioneve vlerësuese në studimet e doktoratës bëhet bazuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

IV. KOMPENSIMI PER POZITAT MENAXHUESE DHE FUNKSIONET TJERA

Neni 15

Kompensimi për pozitat menaxhuese dhe funksionet tjera në nivel të UP-së dhe në njësi akademike

1. Personeli akademik, në rastet kur ushtron funksione përkatëse, përfiton shtesë funksionale për ushtrimin e këtyre funksioneve. Vlera e shtesës nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë të bartësit të funksionit.
2. Nëse pezullohet angazhimi si personel akademik apo profesor universitar gjatë ushtrimit të funksioneve si rektor/e, prorektor/e, dekan/e dhe prodekan/e, aplikohet koeficienti i pagës siç përcaktohet në shtojcën përkatëse të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik. Nëse nuk pezullohet angazhimi si personel akademik gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve, personelit i takon kompensimi për orët e mbajtura deri në 30%.
3. Profesori universitar i pensionuar, të cilit senati ia ka dhënë titullin “Profesor Emeritus”, do të kompensohet përmes një shtese mujore prej 20% të pagës së profesorit të rregullt.
4. Nëse nuk parashihet ndryshe me akt të posaçëm, lartësia e kompensimit për kryetarin/en dhe anëtarët e këshillit drejtues përcaktohet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin/en dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së ZKA-së. Ky kompensim aplikohet për anëtarët e emëruar nga ministria përgjegjëse dhe për anëtarët e zgjedhur nga senati.
5. Personeli akademik përfiton kompensim për pozita dhe funksione shtesë, sipas neneve 32 dhe 38 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik dhe akteve nënligjore në fuqi, bazuar në shtojcën nr. 1 të rregullores;
6. Pavarësisht faktit se personeli akademik mban një ose më shumë funksione shtesë, i njëjti nuk mund të kompensohet më shumë se 20% të pagës bazë, siç përcaktohet me dispozitat

e ligjit përkatës për pagat në sektorin publik. Njësia për financa do të sigurojë zbatimin korrekt të kësaj dispozite.

Neni 16

Përcaktimi i grupeve në studime (për ligjërata dhe ushtrime) me qëllim të kompensimit

Duke marrë parasysh implikimet financiare dhe për qëllime të kompensimit të orëve mësimore, formimi i grupeve të studimit dhe përcaktimi i numrit të studentëve për secilin grup miratohen nga këshilli drejtues me propozim të Senatit të Universitetit të Prishtinës.

V. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT

Neni 17

Vlefshmëria dhe mbikëqyrja e orëve të mbajtura

1. Çdo orë e mbajtur arsyetohet përmes listave elektronike të studentëve, të gjeneruara nga SEMS-i dhe të verifikuara nga prodekani/ja për mësim. Për qëllime kompensimi, listat fizike mund të përdoren si dëshmi për mbajtjen e orës vetëm në raste të veçanta² dhe si përjashtim, për shkak të rrethanave objektive, të cilat duhet të konfirmohen me shkrim nga prodekani/ja për çështje mësimore.
2. Orët e mbajtura online, nëse autorizohen nga organet kompetente, si këshilli i fakultetit, dekani/ja ose senati, arsyetohen në bazë të evidencës së regjistrimit elektronik të prezencës së studentëve, përmes raporteve të gjeneruara nga SEMS-i.
3. Orët e mbajtura nga personeli akademik i pensionuar, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe orët shtesë të punës nga personeli i rregullt kompensohen në muajin vijues, bazuar në raporte (elektronike) të dorëzuara dhe të verifikuara nga prodekani/ja për mësim. Po ashtu, orët e mbajtura nga profesorët vizitorë dhe ekspertët që mbajnë orë klinike kompensohen në muajin vijues, sipas raporteve (elektronike) të dorëzuara dhe të verifikuara nga prodekani/ja për mësim.
4. Raportet e verifikuara nga prodekani/ja për çështje mësimore duhet të dorëzohen për pagesë në shërbimin financiar të njësisë akademike përkatëse deri me datën 3 të muajit vijues. Nëse raportet e verifikuara për muajin paraprak nuk dorëzohen deri më datën 3 të muajit vijues (përjashtuar ditët e pushimit), kompensimi nuk do të mund të realizohet.
5. Raportet për orët e mbajtura që janë më të vjetra se një muaj nuk kompensohen. Si përjashtim, kompensimi mund të realizohet në rastet kur gabimet apo lëshimet e bëra nga zyrtarët përkatës të njësive akademike dhe administratës qendrore (jo stafi akademik) janë

² Në këtë rast “rrethanë e veçantë” konsiderohet ndërprerja e energjisë elektrike dhe problemet eventuale në SEMS dhe pajisjet e SEMS në salla, të cilat konstatohen nga zyra për teknologji të informacionit në UP, ndryshimi i sallave. Në raste të tilla, brenda ditës duhet të njoftohet nëpërmjet emailit zyrtari/ja për mësim dhe prodekani/ja për mësim.

evidentuar dhe dëshmuar me dokumente shtesë. Për këto raste, kompensimi mund të bëhet vetëm pas dorëzimit të një kërkesë të arsyetuar.

6. Në rastet e mosmbajtjes së orëve ose mosdërgimit të raporteve të orëve sipas rregullave në fuqi, dekani/ja i/e njësisë akademike mund të shqiptojë ndalesa financiare, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
7. Në rastet kur nuk ka marrë pjesë asnjë student në orë, pavarësisht pranisë së profesorit apo asistentit, ora konsiderohet e pavlefshme dhe nuk mund të kompensohet.
8. Orët mësimore që bien gjatë festave zyrtare të përcaktuara me ligj duhet të zëvendësohen, përjashtuar rastet kur bartësi i lëndës vlerëson se programi mësimor është realizuar plotësisht, sipas syllabusit të akredituar. Për qëllime kompensimi, për moszëvendësimin e orëve që bien gjatë festave zyrtare dhe për përmbushjen e planprogramit (sipas syllabusit), duhet të njoftohen me shkrim dekani/ja dhe prodekani/ja për mësim.
9. Në rastet kur personeli akademik nuk dorëzon raportin e orëve të mbajtura deri me datën 3 të muajit vijues, përgjegjësia për mosrealizimin e pagesave bie mbi vetë personelin akademik.
10. Përjashtimisht, në rastet kur në muajin përkatës nuk ka mjete të mjaftueshme buxhetore për pagesë, pagesa mund të shtyhet për muajt vijues.
11. Rektori/ja ka të drejtën që në çdo kohë të kërkojë verifikimin e mbajtjes së mësimit për muajin përkatës, për një lëndë të caktuar dhe grup të caktuar të studentëve në njësitë akademike. Verifikimi realizohet në bazë të evidencave zyrtare, përfshirë listat elektronike të studentëve dhe raportet e mësimdhënies të gjeneruara nga SEMS-i. Ky proces kryhet me qëllim të monitorimit dhe mbikëqyrjes së menaxhimit të financave, duke siguruar që alokimi i fondeve për orët mësimore dhe proceset akademike të jetë në përputhje me planifikimet financiare dhe dispozitat ligjore.
12. Njësitë akademike obligohen të ofrojnë të gjitha dokumentet dhe evidencat e nevojshme brenda afateve të caktuara.

Neni 18

Mospërmbushja e detyrave të punës

1. Për shkak të mospërmbushjes së paarsyetuar të detyrave të punës, si: mosmbajtja e ligjëratave dhe ushtrimeve, provimeve, mospjesëmarrja në mbledhjet e organeve kolegjiale (këshillit), komisioneve, departamentit, mentorimin e temave dhe detyrave të tjera, dekani/ja i/e njësisë akademike ka të drejtë të nxjerrë vendim për shqiptimin e ndalesës së kompensimit të personelit akademik deri në 15% të pagës bazë. Rektori/ja mund të shqiptojë masa të tilla ndaj dekanëve dhe vartësve të tjerë në nivel të UP-së.
2. Ndalesa e kompensimit duhet të jetë e arsyetuar dhe të mbështetet në prova të dokumentuara, që vërtetojnë mospërmbushjen e detyrave të punës pa arsye të justifikuar.

Neni 19

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Kjo rregullore fillon të zbatohet duke filluar nga viti akademik 2025/2026.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja me numër protokolli 2/343, e datës 12.10.2023, për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.
3. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është shtojca 1:

3.1 Përmbajtja e shtojcës 1:

- a. Norma e orëve dhe lartësia e kompensimit për orët shtesë të punës së personelit të rregullt akademik;
- b. Orët mësimore dhe kompensimi i personelit akademik të pensionuar (të angazhuar më së shumti deri në moshën 70-vjeçare);
- c. Orët mësimore dhe kompensimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime;
- d. Orët mësimore dhe kompensimi i profesorëve vizitorë;
- e. Orët mësimore dhe kompensimi i ekspertëve të praktikës për mbajtjen e orëve klinike në programet studimore të akredituara, sipas marrëveshjes që ka universiteti ose njësitë akademike;
- f. Orët dhe kompensimi i orëve mësimore të praktikës së studentëve në studimet bachelor, Fakulteti i Edukimit;
- g. Anëtarët e jashtëm të komisionit të doktoratës;
- h. Kompensimi për funksionet shtesë;
- i. Kompensimi për detyrat dhe angazhimet si punë shtesë.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen e internetit të Universitetit të Prishtinës.



Artin Saliti,

Kryesues i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: _____

Datë: ____/____/____

SHTOJCA NR. 1

Norma e orëve dhe lartësia së kompensimit për orët shtesë të punës së personelit të rregullt akademik, orët mësimore të personelit akademik të pensionuar (të angazhuar në mësimdhënie deri në moshën 70 vjeçare) dhe orët mësimore të personelit të angazhuar në cilësi të bashkëpunëtorëve të jashtëm etj.

a. Llogaritja e kompensimit të personelit të rregullt akademik, për orët shtesë të punës

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Paga bazë mbi të cilën llogaritet puna shtesë deri në 30% të pagesë sipas kalkulimeve të bëra për 4 orë në javë ligjeratë/ushtrime	Përllogaritja e kompensimit për një orë ligjeratë apo ushtrime me 30% të pagesë bazë	Totali mujor
1	Profesor/e asistent/e	4	16	1,254 €	23.51 €	376.20 €
2	Profesor/e i/e asocuar	4	16	1,364 €	25.58 €	409.20 €
3	Profesor/e i/e rregullt	4	16	1,474 €	27.64 €	442.20 €
4	Asistent/e	6	24	902 €	11.28 €	270.60 €
5	Lektor/e korepetitor/e	6	24	935 €	11.69 €	280.50 €
6	Ligjërues/e	6	24	1,056 €	13.20 €	316.80 €

b. Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të personelit akademik të pensionuar (të angazhuar në mësimdhënie deri në moshën 70 vjeçare)

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Paga mbi të cilën kalkulohet kompensimi për orë	Kompensimi për orë	Totali mujor
1	Profesor/e asistent/e	4	16	1,254 €	23.51 €	376.20 €
2	Profesor/e i/e asocuar	4	16	1,364 €	25.58 €	409.20 €
3	Profesor/e i/e rregullt	4	16	1,474 €	27.64 €	442.20 €
4	Asistent/e	6	24	902 €	11.28 €	270.60 €
5	Ligjërues/e	6	24	1,056 €	13.20 €	316.80 €

c. Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të personelit të angazhuar nga jashtë Universitetit, në cilësi të bashkëpunëtorëve të jashtëm (pa thirrje akademike në UP), por me gradë shkencore sipas kritereve të përcaktuara

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Kompensimi për orë	Totali mujor
1	Bashkëpunëtor/e i/e angazhuar për ligjërata	6	24	20.00 €	480.00 €
2	Bashkëpunëtor/e i/e angazhuar për ushtrime	10	40	10.00 €	400.00 €
3	Ligjërues/e i/e angazhuar	10	40	11.00 €	440.00 €

d. Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të profesorëve vizitorë

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Kompensimi për orë	Totali mujor
1	Profesor/e vizitorë për ligjërata (nga rajoni përfshirë dhe Bosnien dhe Hercegovinën)	6	24	35.00 €	840.00 €
2	Profesor/e vizitorë për ligjërata (jashtë rajonit)	6	24	45.00 €	1,080.00 €

e. Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të ekspertëve të praktikës për mbajtjen e orëve klinike në programet studimore të akredituara, sipas marrëveshjes që ka Universiteti ose njësitë akademike

Nr.	Thirrja akademike	Orët në javë	Orët në muaj (4 javë)	Kompensimi për orë	Totali mujor
1	Ekspert/e i/e praktikës	4	16	35.00 €	560.00 €

f. Llogaritja e kompensimit të orëve mësimore të praktikës së studentëve në studimet bachelor - Fakulteti i Edukimit

Nr.	Thirrja akademike	Orët në vit	Kompensimi për orë (si kompensimi i orës për asistent)	Totali mujor
1	Profesor/e	Jo më shumë se 3 orë angazhimi për një student	11.28 €	33.83 €

* Këto orë llogariten në kuadër të orëve shtesë. Fakulteti i Edukimit është përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e kësaj pike të shtojcës.

g. Llogaritja e kompensimit të anëtarit të komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës

Nr.	Emërtimi i komisionit/shërbimit	Kompensimi në vlerë bruto
1	Anëtar/e i/e komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës	200 €
2	Anëtar/e jo i/e rajonit: Shpenzimet e qëndrimit deri në vlerë prej 300 €, të arsyetuara me fatura origjinale	300 €
3	Anëtar/e jo i/e rajonit: Shpenzimet e udhëtimit (bileta ose derivate) sipas çmimeve ekonomike të tregut, të arsyetuara me fatura origjinale	
4	Anëtar/e i/e rajonit: Shpenzimet e qëndrimit dhe udhëtimit deri në vlerë prej 300 €, të arsyetuara me fatura origjinale	300 €

h. Kompensimi për funksionet shitesë

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinionit ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB
1	Rektor/e	20%	Kalkulimi bëhet nga njësia e financave në UP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, sipas thirrjes akademike dhe specifikave tjera, në përputhje me ligjin në fuqi.
2	Prorektor/e	18%	Kalkulimi bëhet nga njësia e financave në UP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, sipas thirrjes akademike dhe specifikave tjera, në përputhje me ligjin në fuqi.
3	Dekan/e	15%	Kalkulimi bëhet nga njësia e financave në UP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, sipas thirrjes akademike dhe specifikave tjera, në përputhje me ligjin në fuqi.
4	Prodekan/e	13%	Kalkulimi bëhet nga njësia e financave në UP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, sipas thirrjes akademike dhe specifikave tjera, në përputhje me ligjin në fuqi.
5	Shef/e i/e departamentit (degës, programit) në njësi akademike	125.40 €	Llogaritja e shitesës mujore në lartësi prej 10% të pagës bazë të thirrjes akademike sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196. Kalkulimi shembull i profesorit asistent.
6	Kryesuesi/e i/e Këshillit Drejtues	429.00 €	Këshilli drejtues është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit. Llogaritja është bërë në lartësinë prej 30% të pagës bazë të ZKA-së.
7	Anëtar/e të Këshillit Drejtues	286.00 €	Këshilli drejtues është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit. Llogaritja është bërë në lartësinë prej 20% të pagës bazë të ZKA-së.
8	Profesor/e Emeritues	294.80 €	Llogaritja e shitesës mujore në lartësi prej 20% të pagës bazë të profesorit të rregullt universitar, sipas përcaktimit të paragrafit 2 të nenit 32 të Ligjit Nr. 08/L-196.
9	Këshilli i etikës	112.86 €	Llogaritja në lartësi prej 9% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
10	Anëtar/e i/e Senatit	112.86 €	Llogaritja e shitesës mujore në lartësi prej 9% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Nga kjo shitesë përjashtohen menaxhmenti qendror dhe dekanët e njësive akademike.
11	Kryesues/e i/e Këshillit Drejtues të Bibliotekës Qendrore Universitare	100.32 €	Llogaritja e shitesës mujore në lartësi prej 8% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €.
12	Anëtar/e i/e Këshillit Drejtues të Bibliotekës Qendrore Universitare	62.70 €	Llogaritja e shitesës mujore në lartësi prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €.
13	Këshilli qendror i studimeve të doktoratës	75.24 €	Llogaritja e shitesës mujore në lartësi prej 6% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €.
14	Komisioni i studimeve në nivel qendror	62.70 €	Llogaritja e shitesës mujore në lartësi prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €.
15	Këshilli botues	62.70 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.

16	Komisioni i ankesave dhe parashtresave i Senatit	62.70 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
17	Komisioni për Sigurimin e Cilësisë	62.70 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
18	Komisioni statutar	62.70 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
19	Komisioni për Etikë dhe Kërkime Shkencore	62.70 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.

i. Kompensimi për detyrat dhe angazhimet si punë shtesë

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinioneve ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB
1	Këshilltar/e i/e rektorit	294.80 €	Personeli mbështetës i rektorit përbëhet këshilltari i jashtëm dhe i brendshëm. Në rastin e këshilltarit të jashtëm, kompensimi bëhet përshtatshmërisht me këshilltarin e Ministrisë, ndërsa në rastin e këshilltarit të brendshëm, kompensimi bëhet në lartësinë prej 20% të pagës bazë sipas thirrjes akademike që ka i emëruari. Kalkulimi shembull për profesor të rregullt.
2	Shet/koordinator/e i/e qendrave profesionale në nivel qendror si dhe qendrave që themelohen nga Këshilli drejtues	188.10 €	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 15% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Nëse bartësi i funksionit është asistent, kompensohet 15% të pagës bazës të thirrjes akademike që ka.
3	Koordinator/e për zhvillim akademik (ECTS)	125.40 €	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 10% të pagës bazë të thirrjes akademike sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196. Kalkulimi shembull i profesorit asistent.
4	Drejtor/e i/e institutit (pagesa fillon të implementohet nëse instituti gjeneron të hyra vetanake)	90.20 €	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 10% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 8.2x110 €. Kompensimi fillon të ekzekutohet me rastin e gjenerimit të të hyrave nga instituti.
5	Sekretar/e i/e institutit (pagesa fillon të implementohet nëse instituti gjeneron të hyra vetanake)	45.10 €	Llogaritja e shtesës mujore në lartësi prej 5% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 8.2x110 €. Kompensimi fillon të ekzekutohet me rastin e gjenerimit të të hyrave nga instituti.
6	Komisioni për kërkesa, parashtresa dhe ankesa të Këshillit drejtues	62.70 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
7	Komisioni këshillëdhënës i rektorit për emërimet, rimbërimet dhe avancime të personelit akademik	62.70 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj. Përjashtim, kur shqyrtohen lëndët e konkursit të emërimit/avancimit mund të kompensohen deri në katër mbledhje në muaj.
8	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në UP	62.70 €	Në kohën e mbajtjes së zgjedhjeve, kompensimi bëhet për muaj, deri në 30% të pagës bazë për kryesuesin dhe 20% për anëtarin e komisionit, pas dorëzimit të raportit të punës. Ndërsa, në periudhat tjera, kompensimi për takim bëhet prej 62.70 €, por jo më shumë se për dy takime në muaj.
9	Komisionet këshillëdhënës/profesionale të themeluara nga Këshilli Drejtues, Rektori dhe Senati.	62.70 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime në muaj. Nëse ngarkesa e angazhimit të komisionit të themeluar konsiderohet e lartë, mund të kompensohen më së shumti deri 30% e pagës bazë për kryesuesin dhe 20% për anëtarin e komisionit, pas dorëzimit të raportit të punës.
10	Sekretar/e i/e Departamentit (degës, programit) në njësi akademike	45.10 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Asistentit, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 8.2x110 €. Kompensimi i kësaj pune shtesë duhet të aprovohet me një vendim përkatës nga rektori i UP-së, sipas nenit 8, paragrafi 5 i kësaj rregulloreje.
11	Instruktur/e në Qendrën për përsosmëri në mësimdhënie për orë mësimi/trajnimi	20.00 €	Llogaritja e kompensimit për orët e mësimi/trajnimi, nëse këto orë mbahen për staf që nuk është pjesë e Universitetit të Prishtinës (UP), realizohet nga të hyrat e gjeneruara nga qendra përkatëse. Ndërsa, në rastet kur trajnimet mbahen për staf të Universitetit të Prishtinës, kompensimi kryhet nga buxheti i UP-së, deri në 30% të pagës bazë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
12	Instruktur/e në qendrat profesionale në nivel të Universitetit për orë mësimi/trajnimi	20.00 €	Llogaritja e kompensimit për orë mësimi/trajnimi, me rastin Qendra gjeneron të hyra dhe si e tillë trajtohet si e hyrë e instituteve pasi është shërbim për ekonominë.

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinioneve ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB
-----	-----------	---------------------------	--

1	Mentor/e në punimin e diplomës të studimeve master	100.32 €	Llogaritja në lartësinë prej 8% të pagës bazë të Profesorit asistent, sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi bëhet për tri (3) mentorime gjatë një viti akademik, pasi të jetë plotësuar numri i mentorimeve sipas normës së rregullit. Norma e mentorimeve të punimeve Master është 3 punime për vit akademik. Kompensimi realizohet në shkurt, korrik-shtator.
---	--	----------	--

Nr.	Funksioni	Lartësia e kompensimit	Llogaritja e kompensimit në bazë të Opinioneve ligjor me nr. reference 167/2023, datë 7.6.2023 të Departamentit Ligjor/MPB
-----	-----------	---------------------------	--

1	Mentor/e i/e disertacionit të doktoratës	1,128.60 €	Llogaritja në lartësinë prej 5% të pagës bazë të Profesorit asistent sipas klasës dhe koeficientit si në Shtojca Nr. 8 të Ligjit Nr. 08/L-196, apo 11.4x110 €. Kompensimi prej 1,128.60 € është kumulativ për 18 muaj dhe kompensohet pas mbrojtjes së punimit të doktoraturës. Pagesa realizohet në periudhën shkurt, korrik-shtator të vitit përkatës. Brenda një viti akademik nuk mund të kompensohet më shumë se një mentorim.
---	--	------------	---